

**Autor:** Aldo MERKOÇI –Drejtor Ekzekutiv, Lëvizja MJAFT!

**Kontribuoi:** Xheni Lame

## Qeverisja e hapur e Kuvendit në rajon dhe në Republikën e Shqipërisë

Rekomandime për përmirësimin e situatës.

Gusht 2019



Ky projekt është mbështetur financiarisht nga Bashkimi European. Opinonet, gjetjet dhe rekomandimet janë të autor-it/ve dhe nuk përbëjnë domosdoshmërisht pikëpamjet e donatorëve.

**Autor:** Aldo Merkoçi, Lëvizja MJAF!

**Qeverisja e hapur e Kuvendit në rajon  
dhe në Republikën e Shqipërisë**  
Rekomandime për përmirësimin e situatës.

**Tiranë, Gusht 2019**

## Hyrje

Në bashkëpunim me partnerët nga rajoni, të rrjetit ActionSEE, Lëvizja MJAFT! ka përgatirë këtë punim për të analizuar nivelin e transparencës, hapjes institucionale dhe llogaridhënies së institucioneve legjislative në rajonin e Ballkanit Perëndimor.

Ky punim vjen si rezultat i një kërkimi gjithëpërfshirës, bazuar në metodologji të zhvilluar nga partnerët e programit ActionSEE në të gjitha vendet e rajonit, përgjatë muajve të shkuar. Qëllimi është të paraqitet një përshkrim i situatës aktuale përmes matjeve objektive të hapjes institucionale të kuvendeve në rajon dhe për të parashtruar një set me rekomandime, për të përmirësuar situatën. Gjithashtu, ky punim synon forcimin e mirëqeverisjes dhe të ndihmojë institucionet t'i zbatojnë ato efektivisht në punët e tyre.

Propozimet e këtij punimi përfaqësojnë të dokumentin e tretë të realizuar në kuadër të ActionSEE, shoqëruar me analiza dhe rekomandime. Në vijim të kërkimit të parë të realizuar në vitin 2016, metodologjia kërkimore u përmirësua bashkë me treguesit e saj, duke e bazuar punën tonë në gjetjet dhe rezultatet e kërkimit. Hulumtimi i këtij viti u zhvillua mbi bazën e treguesve që ofrojnë një panoramë të saktë të kuvendeve të rajonit, të cilët janë duke punuar për përmirësimin e hapjes institucionale përgjatë vitit të fundit.

Të gjithë institucionet legjislative në rajon duhet të sigurojnë hapje të plotë institucionale të punës së tyre, si dhe të demostrojnë llogaridhënie politike dhe respektim të parimeve bazë të demokracisë. Duke siguruar gjithë informacionin relevant, kuvendet duhet të ofrojnë transparencë të plotë të punës së tyre. Vetëm institucionet e hapura dhe llogaridhënese mund të punojnë drejt krijimit të një shoqërie demokratike, të cilën janë duke u përpjekur për ta arritur të gjitha vendet e rajonit.

Sipas studimit të këtij viti, Kuvendi i Malit të Zi mbetet institucioni më i hapur në rajon, i cili publikoi të dhënat dhe dokumentat më të rëndësishme të punës së tij. Megjithatë, paraqitet një stanjacion për sa i takon instrumentave shtesë për të rritur ndikimin e politikës së hapjes institucionale. Rezultatet tregojnë se përgjatë vitit të shkuar, kuvendet e rajonit nuk punuan mbi përmirësimin e kësaj fushe. Kështuqë, një rezultat i mirë rajonal nuk duhet të na bëjë optimistë ndaj situatës, sepse Kuvendi i Malit të Zi ka ende shumë punë për të bërë sa i takon përshtatjes së standardeve të hapjes institucionale, ashtu sikurse edhe kuvendet e tjera të rajonit.

Ky punim i drejtohet të gjithë vendimmarrësve të Kuvendit të Shqipërisë dhe të kuvendeve në vendet e rajonit. Gjithashtu, mund të shërbejë edhe për përfaqësues të organizatave ndërkombëtare dhe të kolegëve të sektorit të shoqërisë civile, të cilët punojnë me çështje të tilla.

Të gjitha sugjerimet, kritikrat dhe diskutimet lidhur me këtë punim janë më se të mirëpritura!

### Hapja institucionale e pushtetit legjislativ në rajon

Rezultatet e kërkimit tregojnë se parlamentet në rajon plotësojnë rreth 65% të treguesve të hapjes institucionale, një përmirësim i lehtë prej 4% krahasuar me raundin e mëparshëm të matjeve. Edhe pse nivelet nuk janë ende në parametrat e duhura, ky rezultat tregon se kuvendet e rajonit kanë vendosur të zhvillojnë politikën e tyre të hapjes institucionale në përputhje me gjetjet dhe rekomandimet e këtij kërkimi.

Hulumtimi i këtij viti nënvizon gjithashtu, se performanca e kuvendeve të rajonit paraqet një shpërndarje të theksuar jo të barabartë. Diferenca e performancës varion nga 46% në rastin e Bosnje & Hercegovinës, deri në 79% në rastin e Malit të Zi. Për më tepër, gjatë tre viteve të ActionSEE, progresi në hapjen institucionale ka qenë jo i balancuar, duke pësuar rënie të performancës në disa shtete.

Institucionet legislative në rajon nuk kanë ende një strategji për të arritur politikën e hapjes institucionale. Këto institucione duhet të bëjnë më shumë në kulturën e tyre administrative, duke kuptuar se informacioni i punës së parlamentit i përket qytetarëve dhe ky informacion iu duhet ofruar atyre në të gjitha format. Politika e hapjes institucionale duhet të zhvillohet në të njëjtin ritëm siç edhe teknologjitë e reja. Kjo, ndër të tjera, do të ndihmonte dhe lehtësonte publikimin e të dhënave në format open data, e mbështetur nga fakti që rezultatet tregojnë se kuvendet në rajon nuk janë të përkushtuara ndaj publikimit të të dhënave në formate të tilla, duke mohuar dhe zvogëluar kështu vlerat e dobishme të informacionit të publikuar.

Mungesa e vullnetit për të punuar në përmirësimin e hapjes institucionale dhe transparencës së kuvendit paraqitet evidente edhe përmes faktit që katër kuvende të rajonit (Serbi, Maqedoni e Veriut, Mali i Zi dhe Bosnje & Hercegovina) nuk i janë përgjigjur pyetësorit të dërguar ndaj tyre, në bazë të të cilit hulumtojmë dhe ekzaminojmë tërësisht procedurat e praktikant e hapjes institucionale. Kjo faktori se edhe ato kuvende që kanë arritur një rezultat të mirë në hapjen institucionale, janë më shumë të prirura të plotësojnë detyrimet formale sesa hapjen institucionale dhe bashkëpunimin me shoqërinë civile dhe qytetarët. Kjo mungesë vullneti për të plotësuar pyetësorët është në vetvete një tregues i nivelit të hapjes dhe interesit në promovimin e hapjes institucionale.

### ***Transparenca, aksesueshmëria dhe komunikimi me qytetarët***

Pavarësisht se ekzistenca e ligjit për të Drejtën e Informimit (FOI) në rajon kontribuon në rritjen e transparencës së kuvendeve, zbatimi i tij mbetet ende detyrë për administratat tona. Është shumë e rëndësishme që kuvendet të realizojnë përpjekje në përmirësimin e proaktivitetit të publikimit të informacionit të punës së tyre.

Edhe pse ndërmjet kuvendeve të rajonit ka edhe institucione që përfaqësojnë praktika të mira kur flasim për publikimin e të dhënave mbi punën e kuvendit dhe parlamentarëve, kuadri ligjor dhe përkushtimi ndaj respektimit të parimeve të hapjes institucionale dhe standardeve ndërkombëtare mbetet në letër. Rezultatet e kërimit tregojnë se shumë prej kuvendeve në rajon ende nuk kanë publikuar informacion mbi aktivitetet e komisioneve parlamentare, materialet origjinale të punës së këtyre komisioneve apo të amendamenteve të depozituara.

I rëndësishëm është edhe fakti që kuvendi ende nuk arrin rezultate të kënaqshme për sa i përket përgatitjes, konsultimit, adaptimit dhe prezantimit në format open data të buxhetit të shtetit.

Kuvendet në rajon nuk përpiqen të investojnë në kanale të reja të komunikimit që mund të përmirësojnë hendekun midis qytetarëve dhe institucioneve të tyre përfaqësuese. Për më tepër, asnjë kuvend nuk ofron mundësinë e paraqitjes së peticioneve elektronike.

Është thelbësore që kuvendet e rajonit të realizojnë përpjekje për të kuptuar plotësisht rëndësinë, rolin dhe opinionin e shoqërisë civile në demokraci dhe të përmirësojnë mekanizmat e bashkëpunimit. Është vënë re se pavarësisht ekzistencës së mekanizmave dhe përcaktimit deklarativ të organeve legjislative, bashkëpunimi parlamentar me shoqërinë civile në rajon në përgjithësi është i cunguar. Kuvendi i Republikës së Serbisë ndërpreu bashkëpunimin e tij me Parlamentin e Hapur, pas protestës së kësaj nisme për mënyrën e debatimit dhe miratimit të Ligjit për Buxhetin e vitit 2018.

### ***Mbikëqyrja parlamentare***

Kuvendet në vendet e Ballkanit Perëndimor kanë baza të mira për të realizuar një rol mbikëqyrës, i cili përfshin procedurat që lejojnë kuvendin të rishikojë qeverinë dhe ta mbajë atë të përgjegjshëm, por edhe të përfshijë ekspertë në komisionet parlamentare në procese konsultative konsultime për çështje specifike legjislative ose politikë-bërëse.

Megjithatë, në nivel rajonal, mbikëqyrja parlamentare duhet të përmirësohet duke vënë theksin në zbatimin e plotë të saj në praktikë. Kuvendet në rajon vazhdojnë ta ushtrojnë këtë funksion në mënyrë formale, gjë e cila na çon në rezultate jo të kënaqshme. Në raportet e dedikuara, të publikuara në Maj 2019, Komisioni Europian përsëriti nevojën për të forcuar kontrollin dhe funksionin mbikëqyrës, në mënyrë që të jenë plotësisht efektive.

Kjo situatë na drejton te konkluzionet e nxjerra nga studimi i vitit të shkuar. Ulja e performancës së kuvendit, si një institucion kyç për sa i takon respektimit të ligjit dhe ushtrimit të mekanizmit të kontrollit, reflektuar në mbikëqyrjen e rrallë dhe sipërfaqësore të pushtetit ekzekutiv, është një sfidë serioze në proceset demokratike dhe në rrugën drejt integritetit europian për të gjitha vendet e rajonit. Të gjithë kuvendet në rajon duhet të bëjnë përpjekje për të zbatuar plotësisht dhe në mënyrë thelbësore mekanizmat ekzistues, duke kontribuar kështu në avancimin e përgjegjshmërisë politike.

### ***Vlerësim i dobët i kontrollit parlamentar dhe sjelljes së deputetëve***

Për të tretin vit radhazi, hulumtimet kanë treguar se puna e kuvendeve në rajon nuk bazohet në vendosjen e një metodologjie unike dhe treguesve të duhur për matjen e rezultateve dhe cilësisë së punës së tyre apo asaj të deputetëve. Referuar bazës ligjore, pritet që kuvendet të kenë aftësinë për të analizuar efektet e ligjeve dhe akteve të tjera ligjore të miratuara nga kuvendi dhe të zbatuara nga qeveritë.

Kur bëhet fjalë për lobimin, situata paraqitet disi më e mirë në vitin 2018, pasi tanimë rezultojnë tre shtete që e kanë të miratuar një ligj të tillë, Serbia, Maqedonia e Veriut dhe Mali i Zi. Ndërsa sa i takon kodit të etikës, Republika e Serbisë përfaqëson të vetmin shtet të rajonit që nuk e ka miratuar një të tillë, pasi edhe Maqedonia Veriore e miratoi këtë dokument në vitin 2018. Sidoqoftë, përfundimi i përgjithshëm është se zbatimi i Kodit të Etikës në nivelin e rajonit në tërësi, mbetet shumë i dobët.

Është thelbësore që kuvendet të cilat ende nuk kanë miratuar Kodin e Etikës ta konsiderojnë këtë çështje si prioritare. Për më tepër, të gjitha kuvendet e vendeve të rajonit duhet të kenë mekanizma të qartë për të zbatuar Kodin e Etikës për deputetët dhe për të sanksionuar shkeljet e standardeve të

sjelljes. Praktikrat nga rajoni tregojnë se shkeljet e Kodit të Etikës në përgjithësi nuk rezultojnë në sanksione për sjellje të gabuar dhe shpesh janë objekt i marrëveshjes politike. Zbatimi i vazhdueshëm i rregullave dhe parimeve të përcaktuara në Kodet e Etikës është thelbësor për ngritjen e nivelit të përgjegjësisë politike dhe besimit të publikut në punën e kuvendit.

### **Qeverisja e hapur e Kuvendit në Republikën e Shqipërisë**

Referuar në rezultatet e gjeneruara nga monitorimi i kryer në periudhën dhjetor 2018 – shkurt 2019, Kuvendi i Shqipërisë ka performuar pozitivisht 72.94% të treguesve të matjes së hapjes institucionale. Ky rezultat paraqitet 17.49% më i lartë në krahasim me mesataren e performancës së rajonit të Ballkanit Perëndimor, por ka shfaqur një rënie të lehtë në krahasim me performancën e institucionit vitin e shkuar. Megjithatë, Kuvendi vazhdon të mbetet institucioni publik me nivelin më të lartë të hapjes, në nivel kombëtar. Por në aspektin politik, institucioni u përball me bojkotimin e vazhdueshëm të pjesëmarrjes së opozitës që prej qershorit të vitit 2018, rikthimin e saj për diskutimin e problematikave universitare që çuan studentët në protestën e dhjetorit 2018, deri në dorëzimin e mandateve të deputetëve të opozitës në shkurt të këtij viti; motivi i bojkotimit dhe dorëzimit të mandateve, sipas përfaqësuesve të opozitës, është inkriminimi i kuvendit.

Për të vijuar me performancën administrative, katër shtyllat e mirëqeverisjes për Kuvendin e Shqipërisë kanë rezultuar si në vijim: 83.43% e treguesve të aksesueshmërisë plotësohen, 78.52% indikatorë pozitivë të efektshmërisë, 82.86% e treguesve të integritetit dhe 62.21% e treguesve të transparencës. E përkthyer ndryshe, vlerën më të ulët Kuvendi i Shqipërisë e arrin në plotësimin e informacionit të buxhetit të shtetit, prokurimeve publike dhe informacionit organizacional. Për sa i takon informacione kryesore të veprimtarisë së Kuvendit të Shqipërisë, mund të gjenden



lehtësisht në faqen zyrtare online të institucionit. Kalandari tre javor, agjendat e mbledhjeve dhe seancave plenare, lista e projektakteve dhe akteve ligjore të miratuara, prezenca e deputetëve dhe rezultatet e tyre të votimit, janë të identifikueshme dhe klikueshme në faqen e parë të ëeb-it. Më poshtë, do të paraqiten disa prej treguesve të performuar gjatë periudhës së studimit.

### ***Përmirësime në Kodin e Etikës së Kuvendit dhe rregullimi i parandalimit të konfliktit të interesit.***

Në studimin e realizuar në vitin e shkuar, Kodi i Sjelljes së Deputetëve në Republikën e Shqipërisë ka qenë në faza diskutimi në komisionet parlamentare. Kodi u miratua në prill të vitit 2018, ku një prej pikave (neni 32) parashikonte hartimin e një udhëzuesi të detajuar për sjelljen në Kuvend. Udhëzuesi i hartuar më 27 shtator 2018, ka për qëllim të plotësojë me shpjegim, interpretim ose me rregulla procedurale, Kodin e Sjelljes së Deputetit të Kuvendit të Shqipërisë<sup>1</sup>. Ndërkohë, mbetet e pandryshuar situata sa i takon nismës për krijimin e një ligji që rregullon veprimtarinë e lobingut në Shqipëri, një çështje e cila për të tretin vit të studimit të "ACTION SEE", rezulton negative. Gjithashtu, mënyra e deklarimit të pasurive të deputetëve vazhdon të jetë manuale dhe aksesimi i tyre është i mundur vetëm përkundrejt kërkesave zyrtare ndaj Inspektoriatit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive.

### ***Transparencë më e lartë institucionale. Plotësim i standardeve të publikimit të prokurimeve publike dhe shpenzimeve buxhetore.***

Transparenca është komponenti i cili ka performuar më ulët krahasimisht me vitin e shkuar, duke ulur kështu performancën e institucionit. Ndërkohë që në faqen zyrtare mund të gjendet informacion për deputetët, anëtarësinë e tyre nëpër komisione, kryetarët dhe zëvendëskryetarët, për punonjësit civil informacioni është më i pakët.

<sup>1</sup> Vendim Nr. 19 "Për miratimin e udhëzuesit të detajuar për sjelljen në Kuvend", datë 27.09.2018, <https://www.parlament.al/Files/RaporteStatistika/Udhezuesi%20ne%20BYRO-i%20zbardhur-%20e%20hene15%20tetor.pdf>

Në faqen e kuvendit mund të gjejmë organigramën e institucionet, por mungojnë emrat e punonjësve civilë dhe pagat apo kategoritë e tyre të pagave.

Për sa i përket planifikimit, mungojnë dokumentat e strategjive dhe programeve vjetore të punës së kuvendit, por raportet e ndërmjetme dhe vjetore të punës janë të aksesueshme në faqe. Ndërsa prokurimet publike nuk kanë një hapësirë në faqen e Kuvendit të Shqipërisë; transparenca e çdo dokumenti në lidhje me procedurën e prokurimeve, shënon vlerën 0.

Referuar transparencës buxhetore, në faqen e kuvendit mund të gjendet informacion mbi buxhetin vjetor të shtetit, por mungon informacioni mbi buxhetin e qytetarit, si dhe tabela e shpenzimeve vjetore të institucionit.

Edhe pse një përqindje e konsiderueshme e aktivitetit të kuvendit është transparente në faqe, ka ende tregues me të cilët duhet punuar më shumë. Rregullorja e kuvendit parashikon që krahas agjendave të sesionit aktual, të publikohet agjendat e sesionit të ardhshëm parlamentar. Në periudhën e monitorimit, dokumenti i publikuar paraqiste agjendat për periudhën janar – korrik 2019 dhe mungonte ai i shtator – dhjetor 2019. Nga ana tjetër, edhe pse procesverbalet mbi mbledhjet dhe seancat plenare gjenden në faqe, publikimi i tyre bëhet shumë vonë në kohë nga momenti kur janë mbajtur mbledhjet. Gjithashtu, rezultatet e votimeve të deputetëve publikohen vetëm në rastet e seancave plenare, por jo për mbledhjet e komisioneve.

Transmetimi i veprimtarisë së kuvendit vazhdon të jetë vetëm video, pa rekorde audio. Transmetimi i plotë është vetëm për seancat plenare, nga televizioni shtetëror, dhe jo për mbledhjet e komisioneve; me përjashtim të disa kronikave të shkurtra të televizioneve kombëtare.

Vlen të theksohet se gjetja e informacionit në mënyrë të thjeshtë në faqen zyrtare të Kuvendit të Shqipërisë nuk është në nivelet e duhura të transparencës; faqja nuk ka search engine, në mënyrë që çdo përdorues të gjejë informacion brenda saj, pa qenë nevoja të jetë njohës apo të ketë punuar më parë me faqen e Kuvendit të Shqipërisë.

***Nivelet e aksesueshmërisë së qytetarëve ndaj Kuvendit të Shqipërisë duhen përmirësuar, gjithashtu. Hartimi i udhëzuesve dhe zhvillimi i trajnimeve për të ofruar të dhëna të hapura dhe të ripërpunueshme mbetet ende një çështje.***

Në terma ligjor, bazuar ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", ende nuk paraqitet e detyrueshme pjesëmarrja e koordinatorëve për të drejtën e informimit në trajnime lidhur me fushën e transparencës. Megjithatë, referuar përgjigjes së pyetësorit dërguar administratës së Kuvendit të Shqipërisë, personi përgjegjës për të drejtën e informimit ka marrë pjesë në trajnimet e mbajtura nga Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, por nuk paraqitet një datë kur këto trajnime mund të jenë organizuar.

Akresi i të dhënave të hapura dhe të përpunueshme paraqitet ende në nivele të ulëta, ku institucioni plotëson vetëm 38.99% të treguesve që masin këtë performancë. Edhe në këtë rast, koordinatori për të drejtën e informimit të Kuvendit të Shqipërisë është shprehur se ka marrë pjesë në trajnimet e mbajtura për open data, por nuk është dhënë një datë kur mund të jenë organizuar ngjarje të tilla. Sa i takon përqindjes së performancës së institucionit në nivel rajonal, vlera e plotësuar paraqitet shumë e përafërt me mesataren e performuar nga rajoni (33.66%).

Organi përgjegjës për të ndjekur performancën e institucioneve lidhur të drejtës së informimit është Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Është kjo zyra e cila, bazuar në monitorimin e situatës, të hartojë udhëzues në ndihmë të institucioneve dhe publikut të gjerë, të interesuar për informacion publik. Ende nuk ekzistojnë apo nuk aksesohen online udhëzues, të cilët ndihmojnë qytetarët të kuptojnë si mund të ankimojnë kërkesat e tyre për informacion me interes publik.

## Metodologjia e kërkimit

Hapja përfaqëson një kusht kyç të demokracisë, pasi ajo u lejon qytetarëve të marrin informacion dhe njohuri të nevojshme për pjesëmarrje të barabartë në jetën politike, vendim-marrje efektive dhe pasjen e institucioneve të përgjegjshme për politikën, të cilat ato ndjekin.

Rreth botës, institucionet ndërmarrin aktivitete të ndryshme me qëllim rritjen e transparencës së tyre dhe llogaridhënien te qytetarët. Indeksi Rajonal për Hapjen e Parlamentit është ndërtuar në qëllim të përcaktimit se në cilën shkallë qytetarët e Ballkanit Perëndimor marrin dhe kuptojnë informacionin e institucioneve të tyre.

Indeksi Rajonal i Hapjes mat shkallën në të cilën Parlamentet e Ballkanit Perëndimor janë të hapur për qytetarët dhe shoqërinë, bazuar në katër parimet bazë si vijon: 1) Transparenca, 2) Aksesueshmëria, 3) Integriteti, dhe 4) Efektshmëria.

Parimi i transparencës përfshin informacionin organizativ, buxhetin dhe procedurat e prokurimeve publike, të cilat janë në dispozicion të publikut dhe të publikuara. Aksesueshmëria është e lidhur me sigurimin dhe respektimin e procedurave për akses të lirë në informacion, duke përmirësuar disponueshmërinë e informacionit përmes mekanizmave të debatit publik dhe forcimin e ndërveprimit me qytetarët. Integriteti përbëhet nga mekanizmi i parandalimit të korrupsionit, mbajtjen e kodit etik dhe rregulloret e lobimit. Parimi i fundit, Efektshmëria i referohet monitorimit dhe vlerësimit të politikave të zbatuara nga Institucionet.

Duke ndjekur standardet ndërkombëtare, rekomandimet sikurse dhe shembuj të praktikave të mira, këto parime janë zhvilluar më tej përmes treguesve specifik cilësorë dhe sasiorë, të cilët janë vlerësuar në bazat e: disponueshmërisë së informacionit në ëbsitet zyrtare, shqyrtimin e kuadrit ligjor për çështje të veçanta, burimeve të tjera të informacionit publik dhe pyetësorëve të dorëzuar në institucione. Përmes rreth 117 treguesve, ne kemi matur dhe analizuar hapjen e kuvendeve në rajon dhe janë mbledhur 1000 të dhëna. Të dhënat e grumbulluara janë ndjekur nga një verifikim i tyre, nga ky rezultoi gabim standard prej +/-3%.

Matjet janë kryer gjatë periudhës Dhjetor 2018 deri në fund të Mars 2019. Një set rekomandimesh dhe udhëzuesish drejtuar institucioneve është hartuar në varësi të gjetjeve kryesore.



This project is funded by  
the European Union

METAMORPHOSIS 



CRTA

CENTER FOR RESEARCH  
TRANSPARENCY AND  
ACCOUNTABILITY

ZaštoNe? 



The "Accountability, Technology and Institutional Openness Network in South East Europe - ACTION SEE" project is implemented by Metamorphosis Foundation, Westminster Foundation for Democracy, CRTA - Center for Research, Transparency and Accountability, Citizens Association Why not?, Center for Democratic Transition, Open Data Kosovo (ODK) and Levizja Mjajt!.